

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Vushtrrisë 2012

Tetor, 2012

***“Letërnjoftimi i Komunave”*** është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Problemet në Komunën e Vushtrrisë.....	6
2. Performanca buxhetore e Vushtrrisë.....	7
3. Investimet kapitale.....	9
4. Aktivitetet e Prokurimit Publik.....	10
5. Administrata në Komunën e Vushtrrisë .....	11
6. Arsimi në Komunën e Vushtrrisë .....	13
7. Shëndetësia në Komunën e Vushtrrisë .....	14
8. Transparenca.....	15
9. Përmbushja e premtimeve zgjedhore 2009.....	16
Burimet.....	19

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Vushtrrisë qeveriset nga PDK (Partia Demokratike e Kosovës). Kryetar aktual i kësaj komune është z. Bajram Mulaku. Ai këtë pozitë e ushtron që nga viti 2007 kur ka fituar mandatin e parë për Kryetar të komunës, ndërsa mandatin e dytë e ka nisur pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale të 2009. Para marrjes së pozitës së Kryetarit të komunës z. Mulaku nga vitit 2002-2007 ka qenë asamblist i Kuvendit Komunal në Vushtri nga radhët e PDK. Fitorja në zgjedhjet e fundit e z. Bajram Mulaku është mundësuar pas zhvillimit të balotazhit mes tij dhe kundër kandidatit Muharrem Shabani nga AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës).

Pas mbajtjes së zgjedhjeve, PDK ka arritur marrëveshje koalicioni me AKR (Aleanca Kosova e Re) dhe PD (Partia e Drejtësisë) për të bashkë-qeverisur komunën e Vushtrrisë. Nga marrëveshja ka rezultuar që AKR të udhëheq me Drejtorinë e Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa PD me Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Katastrit. PDK kësaj udhëheq me dhjetë drejtori të tjera, konkretisht me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Drejtorinë e Inspektionit, Drejtorinë e Urbanizimit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Prokurimit si dhe Drejtorinë për Kulturë.

Koalicioni pas zgjedhor për qeverisjen e komunës së Vushtrrisë mes PDK – AKR dhe PD është shtrirë edhe në Kuvendin Komunal, ku gjithsejtë janë 35 asamblistë: 15 janë nga PDK, 7 nga AAK, 7 nga LDK, 2 nga AKR, 1 PD, 1 LDD, 1 nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim dhe 1 asamblist vjen nga Partia Demokratike Turke e Kosovës. PDK së bashku me partnerët e koalicionit në Kuvendin komunal numërojnë 18 asamblistë. AAK, LDK, Lëvizja për Bashkim dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës përmbajnë opozitën.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, komuna e Vushtrrisë ka dalë t'i këtë 69.870 banorë.

Komuna e Vushtrrisë gjatë dy viteve të kaluara ka shënuar progres evident në rritjen e të hyrave komunale, por në linjën e mallrave dhe shërbimeve janë hasur shifra të konsiderueshme të shpenzimit të parasë publike për darka dhe dreka zyrtare, për udhëtime zyrtare, telefon, mëditje, derivate, reprezentacion e kështu me radhë.

Parregullsi evidente gjatë dy viteve të kaluara janë hasur edhe në mënyrën e menaxhimit të pronave publike, formës së kontraktimit të punëve publike nga komuna e Vushtrrisë si dhe në procedurat e ndjekura në emërtimin e shkollave, rrugëve dhe vendbanimeve tjera më rendësi për qytetin.

Kësisoj, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunë të Vushtrrisë, Sami Istrefi e ka marr nën menaxhimin e tij hapësirën të Ura e Gurit duke e futur nën menaxhimin e tij edhe pjesën më të madhe të Urës. Në atë vend ai ka hapur një restorant, kurse rrymën të cilën e shfrytëzon për restorant e ka të lidhur në sistemin e ndriçimit publik të qytetit, përkatësisht në palestrën sportive.

Janë hasur edhe raste të ndërlidhjes së supozuar mes politikës komunale dhe biznesit vendor më qëllim të përfitimit. Kësisoj kompania "Toni Commerc" nga Vushtrria i ka hequr të gjitha shpenzimet e drekave dhe darkave gjatë ardhjes së kreut të PDK-së në Vushtrri. Darkat apo drekat janë shtruar në restorant "Kalaja" ku kreu i PDK-së është takuar në fushatën e fundit zgjedhore me arsimtarët dhe stafin mjekësor të qytetit. Pas zgjedhjeve, kompania "Toni" ka fituar tenderin komunal për furnizim me naftë dhe derivate të naftës për shkollat e Vushtrrisë për vitin 2010 - 2011. Gjumnazi i qytetit "Eqrem Qabej" ka mbetur pa naftë për ngrohje një javë pas ardhjes së cisternës së naftës të kontraktuar. Kjo ka ndodhur gjatë tre mujorit të parë të vitit 2011.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë i ka dhënë bankës private BKT(Banka Kombëtare Tregëtare) objektin komunal në shfrytëzim. Njëri nga përgjegjësit e kësaj banke në Vushtrri është djali i Kryetarit të komunës. Objekti me një madhësi të gjerë në qendër të qytetit i është dhënë për më pak se një mijë euro qira mujore, përderisa çmimi real në treg i qiramarrjes në atë zonë për një objekt të ngjashëm sillet nga 3 mijë deri në 5 mijë euro në muaj.

Shkollës së mesme "Latit Berisha" në Vushtrri i është ndërruar emri. Emri i ri i shkollës është "Bahri Haxha". I ndjeri Haxha ka qenë vëllai i ish-drejtorit ekzekutiv të PTK-së, Shyri Haxha. Bahri Haxha është vrarë gjatë luftës së fundit si viktimë civile dhe me vonë është shpallur dëshmor me qëllim të emërtimit të shkollës pas tij Drejtori i PTK Shyqri Haxha ka kontaktuar personat përgjegjës nga subjektet e opozitës në Kuvendin Komunal duke kërkuar nga ata pëlqimin e tyre për vënien e emrit të vëllait të tij shkollës. Ai gjatë bisedës me përgjegjësit e opozitës është thirrur në atë që për këtë ka pëlqimin e udhëheqjes komunale të Vushtrrisë, por që i duhet edhe pëlqimi i partive në opozitë. Ndërrimi i emrit të shkollës "Latif Berisha" është bërë në kohën kur Komuna e Vushtrrisë akoma i ka shtatë shkolla të paemërtuara. Të paemërtuara janë, shkolla filllore në fshatin Lummadh, shkolla filllore në fshatin Mihaliq, shkolla filllore Nedakoc, shkolla filllore në Rreznik, dy shkolla filllore në qytetin e Vushtrrisë.

Në Vushtrri ka raste kur formalisht një shkollë mban një emër tjetër, ndërsa në praktikë shkolla mban emër krejt tjetër. Kësisoj ngjet me shkollën e ndërtuar nga ana e Emirateve të Bashkuara Arabe e ndërtuar në fshatin Boberlluk e cila shkollë mban emrin "Sheik Muhamed Bin Rashid Al". Ky emër i kësaj shkolle nuk është hequr asnjëherë nga mbishkrimi i shkollës, por diplomat e asaj shkolle si dhe dokumentacioni tjetër kanë nisur të lëshohen në emër të "Latif Berishes" emërtim ky i hequr nga shkolla e mesme profesionale në qendër të qytetit të Vushtrrisë.

Ndërtimi i objektit të ri të komunës afër sheshit “Hasan Prishtina” po e ngulfat hamamin e vjetër të qytetit të Vushtrrisë, ngase ai ndërtim po bëhet krejt ngjitur hamamit. Në anën tjetër objekti i vjetër i komunës është vënë në shitje nga ana e AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit).

BIK (Bashkësia Islame e Kosovës) ka marr 20 ari tokë nga komuna, në emër të kompensimit të tokës që BIK-u ka lëshuar për varrezat e martirëve të Vushtrrisë. Në kohën kur BIK-u ka lëshuar tokën për varreza (viti 2000) u pat proklamuar nga të dyja palët se toka për varreza po jipet pa ndonjë kompensim specifikë.

Kryesuesi i Kuvendit të Vushtrrisë Habib Mustafa ka dhënë dorëheqje të pa revokueshme nga kjo pozitë në prill të këtij viti (2012). Pak ditë pas dhënies së dorëheqjes është kthyer serish në pozitën nga e cila është dorëhequr.

Ky raport i përpiluar nga Instituti GAP vlerëson ecurit e përgjithshme në këtë komunë, veçmas në dy vitet e fundit, duke numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shfrytëzimit të parëse publike, shkalla e transparencës, prokurimi publik, funksionimi i administratës, dhe po ashtu janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga Kryetari i komunës gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 si dhe ecuria e deritanishme e realizimit të tyre.

## 1. Problemet në Komunën e Vushtrrisë

Mungesa e ujit të pijes, mos menaxhimi i duhur i mbeturinave, fenomeni në rritje i mbindërtimeve në qytet, mungesa e parkingjeve, mungesa e përfshirjes së fshatrave në rrjetin e kanalizimit, ndotja e lumit Tërstena dhe Sitnica, tjetërsimi i tokës së bukës dhe shndërrimi i saj në hapësira ndërtimi, llogariten si problemet më të mëdha lokale në komunën e Vushtrrisë.

Një ndër problemet më të mëdha të qytetarëve të Vushtrrisë është mungesa e ujit të pijes. Të gjitha zonat urbane dhe rurale të kësaj komune ballafaqohen me këtë problem. Reduktimet e ujit gjatë verës në zonat urbane arrijnë deri në 20 orë në ditë. Në gjysmën e dytë të vitit 2011 ka nisur së ndërtuari fabrika e ujit në fshatin Oshlan, e cila planifikohet të inaugurohet në fund të vitit të ardhshëm (2013) dhe kjo besohet që do të ndikojë në zgjidhjen e problemit nga mungesa e ujit të pijes.

Papastërtia në qytet është evidente dhe kjo vërehet pothuajse në të gjitha zonat e qytetit dhe fshatrave përreth. Komuna e ka përzgjedhur një kompani private për menaxhimin e mbeturinave, por kapacitetet e saj janë të pamjaftueshme për mbledhjen e mbeturinave. Në shumë hapësira hasen deponi të egra mbeturinash. Në qytet nuk shihen të vendosura shportat për hedhjen e mbeturinave të imta.

Në objektet e banimit kolektiv në Vushtrri vërehet fenomeni në rritje i mbindërtimeve të cilat bëhen pa respektimin e kriterëve të ndërtimit. Kjo po ndikon edhe në shëmtimin e mëtutjeshëm të pamjes së përgjithshme të qytetit. Përgjegjësit e komunës nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap konkret në parandalimin e këtij fenomeni dhe as ndëshkimin e personave apo subjekteve që ndërmarrin nisma të tilla.

Një problem tjetër serioz më të cilin ballafaqohen qytetarët e Vushtrrisë është ai i mungesës së vendeve për parkim të veturave. Asnjë investim komunal nuk është bërë me qëllim të tejkalimit të këtij problemi. Veturat shihen të parkuara vend e pa vend, shumica në trotuare. Këmbësoret detyrohet të ecin rrugës së paraparë për automjete, duke rritur kështu shkallën e rrezikut nga aksidentet e mundshme. Mungesa e parkingjeve dhe parkimi i veturave vend e pa vend llogaritet të jetë edhe faktor shtesë në shëmtimin e pamjes së qytetit.

Territori i Komunës së Vushtrrisë karakterizohet me prezencën e dy lumenjve, Tërstena dhe Sitnica. Lumi Tërstena ndan përmes qytetin e Vushtrrisë. Autoritetet komunale kanë investuar në shtratin e këtij lumi gjatë vitit 2011. Investimet e bëra kanë pasur vetëm efekt të përkohshëm, ngase ka munguar mirëmbajtje e lumit, gjë e cila ka shkaktuar mbledhjen e mbeturinave në shtrat si dhe mbulimin e tij nga bari. Kontaminimi i rrjedhjes së lumenjve nga derdhja e kanalizimeve dhe hedhja e mbeturinave është dukuri e përditshme. Kundërmimi i erërave dhe përhapja e insekteve nga këta lumenj vështirëson jetën e përditshme të qytetarëve. Komuna nuk ka arritur të minimizojë as rrezikun e daljes së këtyre lumenjve nga shtrati gjatë të

reshurave, ku në të kaluarën një numër shtëpish kanë pësuar dëme nga vërshimet, veçmas në një pjesë të lumit Sitnica.

Në vitin 2011 Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Bujqësi e kishte vendosur Komunën e Vushtrrisë si të parën në mesin e komunave ku është tjetërsuar në shkallë të lartë toka e bukës dhe është shndërruar në tokë ndërtimore. Më e goditur në këtë mes qëndron qarkorja në magjistralen e rrugës Prishtinë – Vushtrri, përkatësisht Pestova dhe ana e quajtur e Çiçavices. E gjithë kjo zonë është nën sistemin e ujitjes së tokave nga kanali i “Iber Lepencit”. E tëra kjo është bërë pa pasur ndonjë masë sanksionuese nga ana e autoriteteve komunale. Rreth 15 hektar tokë buke konsiderohen të tjetërsuara vetëm në tri vitet e fundit.

## 2. Performanca buxhetore e Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë në vitet e fundit ka rritur dukshëm të hyrat komunale, por mbetet shqetësuese shkalla jo e mjaftueshme e mbledhjes së të hyrave nga tatimi në pronë. Autoritetet komunale në Vushtrri kanë publikuar gjatë vitit 2011 listën me emrat e qytetarëve të cilët kanë më shumë se 250 euro borxh nga tatimi në pronë dhe kjo listë përmban emrat e 1.269 personave të cilët nuk i kanë fshirë borxhet e tatimit në pronë, borxh ky që vlerësohet të jetë afro 900.000 euro, shifër kjo që përmbledh vetëm borxhin e qytetarëve dhe subjekteve tjera mbi 250 euro.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale 2009-2012

Viti	Shuma (Euro)
2009	546.000
2010	1.091.000
2011	1.241.000
2012	1.322.000 <sup>1</sup>

Nga tabela e mësipërme vërehet se dallimi mes të hyrave të vitit 2010 dhe atij 2011 ka shënuar rritje progresive në vlerën e 150.000 eurove, ndërkaq nëse krahasimi bëhet me vitin 2009, atëherë shohim se dallimi mes të hyrave ka shënuar rritje afro gjysmë milioni euro.

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Vushtrrisë i vitit 2011

Kategoria	Shuma (Euro)
Investime kapitale	4.394.305
Mallra dhe shërbime	1.051.317

<sup>1</sup> Të hyra të planifikuara për vitin 2012.

Subvencione dhe transfere	159.862
Shpenzime komunale	233.822
Paga dhe mëditje	6.976.528
<b>Totali</b>	<b>12.815.835</b>

Komuna e Vushtrrisë ka një shkallë relativisht të lartë të shpenzimit të parëse publike në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbime. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në këtë kategori komuna e Vushtrrisë gjatë një viti ka në dispozicion 1.051.317 euro. Në fund të vitit 2011 shkalla e borxhit që ka pasur komuna e Vushtrrisë ka qenë 129.000 euro. Krahasimi i kësaj shifre me vitet paraprake rezulton me një rritje të vogël të shkallës së borxhit, konkretisht në fund të 2010 Komuna e Vushtrrisë fatura të papaguara ka pasur në vlerën e 110.000 eurove.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori e mallrave dhe shërbimeve në 2011 dhe 2010 nga Komuna e Vushtrrisë

Kategoria	Shuma (euro)	
	2011	2010
Shpenzimet e udhëtimit	12.914,64	22.720,00
Shpenzime në telefonin 'vala'	23.197,10	22.219,80
Shpenzimet në telefonin fikse	19.829,67	17.487,96
Shërbimet kontraktuese tjera <sup>2</sup>	325.562,10	285.340,20
Naftë për ngrohje qendrore/ blerja e thëngjillit dhe druve	174.704,61	130.080,00
Karburante për vetura	67.347,54	61.100,00
Mirëmbajtja e automjeteve dhe ndërtesave	110.710,86	72.530,40
Dreka Zyrtare	38.497,33	24.000,50

Rritja e shpenzimeve në kategorinë e mallrave e shërbimeve për vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 kanë qenë 20% më të larta.<sup>3</sup> Përveç kategorisë së udhëtimeve që ka shënuar rënien në vitin 2011 krahasuar me një vit më herët, të gjitha kategoritë tjera kanë shënuar rritje të shpenzimeve. Kësisoj, krahasimi i të dhënëve të mësipërme rezulton se për dreka dhe darka zyrtare në vitin 2011 janë shpenzuar 14.500 euro më shumë së një vit më herët, ndërsa në kategorinë 'Shërbimet kontraktuese tjera' gjatë 2011 janë shpenzuar afro 41.000 euro më shumë së një vit më herët.

<sup>2</sup> Nuk specifikohet në raport lloji i shërbimeve.

<sup>3</sup> Komuna e Vushtrrisë. Raporti financiar janar – dhjetor 2011. Fq 17.



Tabela nr.4: Shpenzimet në tetë mujorin e parë të vitit 2012 në disa kategori në komunën e Vushtrrisë

Kategoria	Shuma (euro)
	2012
Shpenzime në telefonin 'vala'	16.459,59
Shpenzimet në telefonin fikse	11.436,24
Karburante për vetura	74.813,74
Dreka Zyrtare	19.600,92

Kategoria ku vërehet rënie e lehtë e shpenzimeve në komunën e Vushtrrisë është ajo e shpenzimeve komunale, ku gjatë vitit 2011 ka pasur më pak shpenzime në këtë linjë të buxhetit.

Tabela nr.5: Shpenzimet gjatë 2010 dhe 2011 në kategorinë e shpenzimeve komunale në Vushtri

Kategoria	Shuma (euro)	
	2011	2010
Shpenzime për energji elektrike	125.864,40	137.842,34
Shpenzimet për ujësjellës	34.444,33	34.090,40
Shpenzimet për mbeturina	34.522,76	38.599,82
<b>Gjithsejtë</b>	<b>194.831,49</b>	<b>2010.532,56</b>

### 3. Investimet kapitale

Investimet kapitale në komunën e Vushtrrisë gjatë dy viteve të kaluara (2010-2011) kanë pasur një shtrirje relativisht të gjerë duke përfshirë rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit dhe objekteve tjera përcjellëse në sferën e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka komuna e Vushtrrisë në dispozicion për investime kapitale gjatë një viti është mbi 4.3 milionë euro.

Në tabelën nr.6: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Vushtrrisë të realizuara gjatë vitit 2011

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Vlera (euro)
Ndërtimi i urës mbi lumin "Sitnica"	374.672,65
Rregullimi i infrastrukturës së rrugës "Hani i Hysenit"	40.809,00
Asfaltimi i rrugës Dobërllukë -Vushtri	84.843,31
Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtitaricë	69.804,00

Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Prelluzhë	91.100,00
Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Mihaliq, lagja "Gela" "Bunjaku" dhe "Mustafa"	132.548,45
Asfaltimi i rrugës në fshatin Reznik - Shallc	98.88,87
Asfaltimi i rrugës Stanofc i Poshtem - Hekurudhë - Prelluzhë	125.258.80
Asfaltimi i rrugës në fshatin Lum Madh - Stanofc i Ulët	191.983,40
Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pestovë	59.235,95
Asfaltimi i rrugëve lokale brenda qytetit në pesë faza	659.368,59
Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatëra në katër faza	293.643,00

Në tabelën nr.7: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Vushtrrisë të realizuara gjatë vitit 2010

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Vlera/euro/000
Asfaltimi i rrugës në fshatin Doberllukë	224.843,31
Asfaltimi i rrugës në fshatin Bajске	124.734,90
Ndërtimi me kubza betoni i trotuarit në fshatin Shtitaricë	14.689,50
Asfaltimi i rrugës në fshatin Dolak- lagja "Kuqi"	22.034.57
Asfaltimi i rrugës Bivolak - Hamidi	86.241.36
Vazhdimi indertimit me kubza betoni të rrugës "Shote Galica"	34.074.20
Asfaltimi i rrugës në fshatin Zhilivodë, lagja "Nicaј"	46.764.00
Ndërtimi i urës në fshatin Samadrexhe, lagja "Bunjaku"	5.944.80
Rregullimi me kubza betoni i rrugës në fshatin Bukosh, lagja "Mehana", "Gashi" dhe në lagjen "Shaqiri"	24.555.00
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Maxhunaj, lagja "Zekolli" dhe në lagjen "Qelaj"	89.272.80
Asfaltimi i rrugës në fshatin Samadrexhë, lagja "Bunjaku", "Shala", "Maloku" dhe "Musa"	38.977.00
Vazhdimi i asfaltimit të rrugës Karaqë - Skromë	79.992.36

#### 4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Komuna e Vushtrrisë bashkë me komunën e Lipjanit janë të vetmet në Kosovë të cilat Zyrën e Prokurimit e kanë avancuar në nivel të drejtorisë së veçantë për prokurim. Në këtë drejtori janë gjithsejtë katër persona të punësuar dhe krahas ekzistimit të pozitës së drejtorit të prokurimit është funksionale edhe pozita e menaxherit për prokurim. Për dy vite (2010-2011) Komuna e Vushtrrisë ka lidhur 528 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave rreth 9 milionë euro.

Tabela nr.8: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë  
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave
2010	282	4.029.192,62
2011	246	4.850.559,44
<b>Totali</b>	<b>528</b>	<b>8.879.752,06</b>

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Sipas raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011, vlerësimi i mostrës të prokurimit publik ka rezultuar me disa të gjetura të cilat sipas auditorit janë në shpërputhje me procedurat e prokurimit publik. Kësisoj, te kontrata për pastrimin e objekteve shkollore në shumën 77.770 euro, Drejtoria e Arsimit i ka paguar operatorit ekonomik dy fatura nga 4.481 euro për muaj, pa pranuar asnjë raport nga drejtoritë e shkollave për kryerjen e këtij shërbimi. Kjo, sipas Auditorit, nënkupton se Komuna e Vushtrrisë nuk ka kontrolle adekuate mbi proceset e prokurimit. Kryerja e pagesave pa raporte të pranimit, shton rrezikun që komuna të bëjë pagesa për punët të cilat fare nuk janë kryer.<sup>4</sup>

Sipas po këtij raporti, nga zyrtari i Drejtorisë së Arsimit janë tërhequr 5.000 euro avanc për udhëtim zyrtar për vizitë në Turqi. Nga ky avanc janë blerë bileta aeroplani, pa procedura të prokurimit, në agjencinë turistike "Fibula" në Prishtinë me para të gatshme në shumë 4.114 euro. Po ashtu, komuna e Vushtrrisë nuk mban dëshmi të mjaftueshme për shpenzimin e bërë, siç janë biletat e aeroplanit për secilin zyrtar që ka udhëtuar.

## 5. Administrata e Komunës së Lipjanit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Vushtrrisë është 244 persona duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit dhe në sferën e shëndetësisë. Së bashku me këta dy sektorë numri i përgjithshëm i të punësuarve në Vushtrri është 1.517 të punësuar.

Tabela nr.9: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Vushtrrisë

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	4
Drejtoria e Administratës	42
Drejtoria e Prokurimit	4
Drejtoria e Financave	28

<sup>4</sup> [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KVU\\_2011\\_Shqip\\_852842.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KVU_2011_Shqip_852842.pdf)

Drejtoria e Urbanizimit	9
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim rural	7
Sektori i Arsimit	1.069
Drejtoria e Arsimit	8
Sektori i Shëndetësisë	204
Drejtoria e Shërbimeve publike & Zjarrfikësit	48
Zyra e komuniteteve	15
Drejtoria për Kulturë-Rini dhe Sport	35
Drejtoria e Shëndetësisë	6
Drejtoria e Inspektionit	14
Drejtoria për gjeodezi dhe kadaster	11
Qendra për Punë Sociale	9
Drejtoria për Mbrojtje dhe shpëtim	4
<b>Gjithsejtë</b>	<b>1.517</b>

Nga te dhënat e mësipërme rezulton një ndarje jo e duhur e numrit të të punësuarve në dikasteret e Komunës së Vushtrrisë.<sup>5</sup> Disa drejtori që vlerësohet të kenë punë më të ngarkuar kanë më pak të punësuar, ndërsa disa drejtori dhe dikastere tjera që potencialisht kanë më pak punë vërehet një numër më i madh i të punësuarve. Kështu është e paqartë se pse në Zyrën për komunitete do të duhet të ishin të punësuar 15 persona, përderisa në të gjitha komunat tjera kjo zyre menaxhohet nga një deri në dy persona. Pastaj, Drejtoria për Kulturë del të ketë numër më të madh të punësuarish se sa të gjitha drejtoritë tjera, përjashtimisht Drejtorisë së Administratës.

Sipas raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 janë vërejtur kontrole të pamjaftueshme në dosjet dhe rekrutimin e personelit. Me konkursin e shpallur për plotësimin e vendeve të lira të punës të personelit arsimor për vitin shkollor 2011-2012 janë pranuar edhe shtatë punëtorë tjerë emrat e të cilëve nuk figurojnë në procesverbalin e komisionit pranues. Përzgjedhja e pesë kandidatëve për zëvendësim (për punëtorët që kanë shkuar në pushim të lehonisë) është bërë pa procedura të rekrutimit. Ndonëse në numër të kufizuar, Auditori gjithashtu, ka hasur në dukurinë e mungesës së kontratave të pa nënshkruara nga ana e punëmarrësit.<sup>6</sup>

Po ashtu sipas Auditorit në shumë raste, në dosjen e punëtorit nuk figuron kontrata e fundit por vetëm vendimi për ndërprerje të punës. Në njërin nga mostrat, në shpallje të konkursit nuk definohej saktësisht kualifikimi i kërkuar për vendin e caktuar të punës dhe nuk zbatohen format e reja të aplikimit për rekrutim, siç janë të parapara me

<sup>5</sup> Të dhënat për numrin e të punësuarëve janë bazuar në skemen e të punësuarëve të komunës së Vushtrrisë nga raporti financiar 2010.

<sup>6</sup> [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KVU\\_2011\\_Shqip\\_852842.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KVU_2011_Shqip_852842.pdf)

Rregulloren 01/2010 Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil. Dosjet fizike të personelit ekzistojnë, por nuk janë të plota. Dosjeve u mungojnë origjinalet e vlerësimit gjatë procedurës së rekrutimit, përshkrimi i punëve, formulari i vlerësimit vjetor të punëtorit.<sup>7</sup>

Nga gjithsejtë 12 drejtori sa ka komuna e Vushtrrisë, asnjë nga to nuk udhëhiqen nga femrat dhe po ashtu numri i femrave të punësuar në dikasteret e komunës mbetet tejet i vogël.

## 6. Arsimi në Komunën e Vushtrrisë

Në komunën e Vushtrrisë funksionojnë gjithsejtë 46 shkolla fillore (objekte shkollore), tri shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në çerdhen e qytetit janë të sistemuar 169 fëmijë, prej tyre 94 meshkuj dhe 75 femra. Komuna e Vushtrrisë numëron edhe 542 fëmijë të inkuadruar në sistemin para-shkollor ku 186 janë meshkuj dhe 356 janë femra.

Tabela nr.10: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në 46 shkollat fillore të Vushtrrisë:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	305	11
Meshkuj	356	170
<b>Gjithsejtë</b>	<b>661</b>	<b>181</b>

Në komunën e Vushtrrisë ekzistojnë tri shkolla të mesme të profilit gjimnaz dhe shkolla profesionale teknike.

Tabela nr.11: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në shkollat e mesme të Vushtrrisë

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	54	3
Meshkuj	150	20
<b>Gjithsejtë</b>	<b>204</b>	<b>23</b>

<sup>7</sup> [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KVU\\_2011\\_Shqip\\_852842.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KVU_2011_Shqip_852842.pdf)

Tabela nr.12: Numri total i mësimdhënëseve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 46 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme në Komunën e Vushtrrisë

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	865	359	510
Nxënës	17.128	7.812	9.316
Stafi ndihmës	204	14	190

Në komunën e Vushtrrisë gjatë dy viteve të kaluara është shënuar përparim në përmirësimin e infrastrukturës në objektet arsimore. Shkollat përgjithësisht janë gëlqerosur, janë ndërtuar disa objekte të reja arsimit, janë ndërruar dyert dhe dritaret, janë ndërtuar salla të sporteve dhe investime ka pasur edhe në ambientet e jashtme.

Tabela nr.13: Disa nga investimet gjatë 2011 në infrastrukturën e shkollave të Vushtrrisë:

Investimet	Shuma (euro)
Riparimi i shkollave në Dobërllukë, Novolan, Mihaliq dhe Samadrexhë	630.000
Renovimi i dyshensë në shkollën fillore "Emin Duraku" - Novolan	12.785,00
Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Bukosh	120.303,88
Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Zhilivodë, 'Faza e parë'	58.666,04
Ngjyrosja e brendshme e sh.f. "A.Z.Çajupi "	2.193,72
Rregullimi i infrastruktures të sh.f. në fshatin Vesekofc	6.149,05
Ndërtimi i fushës sportive në shkollën fillore "Bahri Kuqi "	15.954,40
Ngjyrosja e gjimnazit "Eqrem Çabej"	9.953,90

## 7. Shëndetësia në Komunën e Vushtrrisë

Në komunën e Vushtrrisë funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), tetë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe tetë punkte shëndetësore apo ambulanca. Kësisoj, rrjeti shpërndarës i objekteve shëndetësore në Vushtrri ka një shtrirje të gjerë dhe mbulon gjithë territorin e komunës.

QKMF gjendet në qendër të qytetit, ndërsa QMF janë të shpërndara, një e tillë gjendet brenda qytetit, një në fshatin Novolan, pastaj në Lumadh, Pantinë, Druar, Smerkonic, Dumnicë, dhe një në fshatin Maxhunaj. Po ashtu edhe punktet shëndetësore, janë të shtrira në fshatrat e kësaj ane. Punktet shëndetësore gjenden në Skromë, Doboc, Beçiç, Ashlan, Strofc, Pasomë, Samadrexh dhe një ambulancë gjendet në fshatin Ceceli.

Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në komunën e Vushtrrisë është 204 të punësuar, pjesa më e madhe prej tyre në QKMF.

Tabela nr.14: Numri dhe pozitat e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë së Vushtrrisë

Pozitat	Numri
Specialist të mjekësisë Familjare	17
Doktor të mjekësisë	14
Stomatolog	7
Biokimist klinik	1
Infermier	122
Teknik laborant	7
Teknik të rëntgenit	5
Teknik i farmacisë	1
Punëtor administrativ dhe teknik	30
<b>Gjithsejtë</b>	<b>204</b>

## 8. Transparenca

Zyra për Informim në komunën e Vushtrrisë funksionon brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo komunë mbulohet rregullisht nga mediumet e shkruara të cilat kanë të angazhuar korrespondentë nga ky lokalitet. Cilësia dhe sasia e informatave që korrespondentët marrin nga ana e autoriteteve lokale vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme. Vushtria ka edhe një radio lokale e cilat angazhohet t'i mbulojë zhvillimet e përgjithshme në këtë komunë.

Faqja zyrtare është mirë e mbuluar më të dhëna dhe informata. Nga të gjitha faqet zyrtare që kanë komunat e vendit, faqja zyrtare e komunës së Vushtrrisë mirëmbahet më së miri dhe gjenden shumëllojshmëri informatash të postuara. Risi në këtë faqe zyrtare, për dallim nga komunat e tjera është edhe fakti që haset hapësira e caktuar e titulluar 'këndi i opozitës' ku përfaqësuesit e subjekteve opozitare mund t'i shprehin komentet, sugjerimet dhe opinionet e tyre.

Tabela: nr15: vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Vushtrrisë  
<http://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	√	x	x	x	√	x

Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Buxhet dhe Financa	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Prokurim	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	√								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	√								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√								

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.



## 9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.z.Bajram Mulaku, para elektoratit të tij ka prezantuar 15 premtime për sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela nr.16: Vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2010. Në këtë tabelë janë përfshirë 15 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Vushtrrisë, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 5 premtime janë përmbushur, 7 nuk janë realizuar, ndërsa në 3 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen premtime të përmbushura:

Premtimet	Realizueshmëria
Ndërtimin e fabrikës për përpunimin e ujit të pijshëm në fshatin Balincë	Kjo ka nisur para një viti, por akoma nuk është përfunduar dhe nuk ka ndonjë datë se kur mund të pritët përfundimin i ndërtimit të kësaj fabrike.
Rrjetin e ujësjellësit në pjesën perëndimore që përfshin 15 fshatra. Furnizimin me ujë të pijshëm për fshatin Dubovc.	Në disa fshatra ka pasur investime në rrjetin e ujësjellësit, por uji mungon edhe përkundër rrjetit.
Sigurimin e ujit të pijshëm 24 orë në ditë deri në fund të vitit 2010	Nuk është bërë. Aktualisht njeri ndër problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohen qytetarët e kësaj komune është mungesa e ujit të pijes.
Deponimin dhe riciklimin e mbeturinave	Nuk është bërë. Mbeturinat nga kompanitë për mbledhjen e tyre i dërgojnë ato në deponin e Mitrovicës.
Rikonstruimin e bazeneve në lumin Sitnicë dhe largimin e mbeturina në urën e lumit Sitnica	Premtim i papërmbushur. Nuk është punuar asgjë në lumin Sitnica. Është punuar vetëm në lumin Terstena.

Ndërtimin e kolektorit përmes lumit i cili do të pastroj ndotjen	Premtim i papërbushur.
Përkrahjen e fermerëve dhe prodhimtarisë bujqësore, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura kodrinore-malore	Ka pasur hapa inkurajues në këtë sferë, por rezultatet janë evidente edhe fal donacioneve që komuna i ka marr për këtë qëllim nga donatori IDA si dhe nga MBPZHR.
Themelimin e Entit të Patates	Premtim i papërbushur.
Mbjelljen e fidanëve	Ka pasur kohe pas kohe mbjellje të fidanëve në vendet e ndryshme, por përgjithësisht ka munguar kujdesi për to, gjë e cila ka rezultuar në shumicën e rasteve me tharjen dhe zhbërjen e tyre.
Projektim detajor për rregullimin e hapësirës së gjelbër tek Ura e Gurit	Ura e Gurit nuk është gjelbëruar, por është rrethuar dhe komercializuar nga privatisht nga vete zyrtarët e lartë të Komunës së Vushtrrisë.
Ndërtimin e parkut të biznesit (ku do të hapen 2.000 vende të reja të punës)	Premtim i papërbushur.
Rregullimin e dy shesheve “ Dëshmorët e Kombit” dhe sheshit “Hasan Prishtina”	Sheshi “Dëshmoret e Kombit” është relativisht i rregulluar dhe plotëson standardet minimale për t’u vlerësuar si premtim i përmbushur. Ndërsa sheshi “Hasan Prishtina” akoma nuk ka nisur dhe as që ka ndonjë datë se kur mund të pritet e terë kjo. Ky shesh është paraparë të bëhet në vendin ku aktualisht është objekti i vjetër i komunës, fillimisht pritet rrënimi i objektit dhe tek pastaj nisja e hartimit të planit ideor për sheshin.
Ndërtimin e rrugës në Samadraxh më së largu deri në vitin 2011	Kjo është bërë.
Largimin e tregut pranë hamamit si dhe restaurimin e kalasë	Premtim i përmbushur.
Hulumtime arkeologjike dhe restaurime për mbrojtjen e monumenteve historike	Ka qenë një fond i ndarë nga komuna për këtë qëllim për Institutin Arkeologjik të Kosovës.

## Burimet:

1. Komuna e Vushtrrisë. Raporti financiar 2011.
2. Komuna e Vushtrrisë. Raporti financiar 2010.
3. Komuna e Vushtrrisë. Raporti i punës së Kryetarit të Vushtrrisë 2011.
4. Komuna e Vushtrrisë. Raporti i punës së Kryetarit të Vushtrrisë 2010.
5. Komuna e Vushtrrisë. Raporti i të punësuarëve në Komunën e Vushtrrisë.
6. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për 2011. [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KVU\\_2011\\_Shqip\\_852842.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KVU_2011_Shqip_852842.pdf)
7. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë. <http://kk.rks-gov.net/vushtrri/>
8. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendror e.aspx>
9. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
10. Raportet vjetore 2010 -2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90)
11. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Vushtrrisë. [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
12. Komuna e Vushtrrisë. Raporti i punës së Drejtorisë së shëndetësisë të Komunës së Vushtrrisë. <http://kk.rks-gov.net/vushtrri/getattachment/cc01b66b-6f92-4788-8a74-5b5b2fb24298/Raporti-i-punes-se-Drejtorise-per-shendetesi-dhe-m.aspx>
13. Komuna e Vushtrrisë. Raporti i punës së Drejtorisë së Arsimit. <http://kk.rks-gov.net/vushtrri/getattachment/464acf36-3ea1-4062-b068-5abbf3a989f0/Raporti-i-punes-se-Drejtorise-per-Arsim-per-vitin-.aspx>
14. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Raporti i Regjistrimit të Popullësisë, ekonomive familjare dhe banesave. [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)